VENDIM
Nr. 217, datë 27.10.2021

MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË OSSH SHA PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT TË ERE-s NR. 181, DATË 23.11.2016, "PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 104, DATË 23.6.2016, TË BORDIT TË ERE-s, "MBI PËRCAKTIMIN E METODOLOGJISË SË VLERAVE REFERUESE, NË RAST SE TË DHËNAT E MATJES JANË PËRKOHËSISHT TË PADISPONUESHME DHE TË PAARRITSHME, SI DHE MBI SHFUQIZIMIN E VENDIMEVE TË ERE-s NR. 49, DATË 21.10.2004 DHE NR. 146, DATË 24.12.2013"

Në mbështetje të neneve 16 dhe 76, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; dhe neneve 15, 19 dhe 26, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 27.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 136/4 prot., datë 20.10.2021, të drejtorive teknike, "Mbi shqyrtimin e kërkesës së OSSH sh.a. për ndryshimin e vendimit të ERE-s nr. 181, datë 23.11.2016, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 104, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, "Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese, në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarritshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004 dhe nr. 146, datë 24.12.2013",

konstatoi se:

- OSSH sh.a. ka paraqitur pranë ERE-s kërkesën me nr. 4927 prot., datë 31.5.2021, protokolluar në ERE me nr. 715 prot., datë 2.6.2021, për ndryshimin e vendimit të ERE-s nr. 181, datë 23.11.2016, për disa ndryshime në vendimin nr. 104, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, "Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese, në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarritshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004 dhe nr. 146, datë 24.12.2013.
- Me shkresën nr. 4927 prot., datë 31.5.2021, OSSH sh.a. ka bërë me dije se ka faturuar me vlerë referuese zëvendësuese të gjithë përdoruesit e saj, në rastet kur konstaton se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme për një periudhë më të gjatë së një muaj (matësi është i dëmtuar, matësi është jashtë kushtit teknik apo mungon aksesi në të dhënat e matjes), në zbatim të vendimeve të bordit të ERE-s nr. 104, datë 23.6.2016, të ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181, datë 23.11.2016.
- OSSH sh.a. ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 181/2016, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 104, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, "Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese, në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarritshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004 dhe nr. 146, datë 24.12.2013", pika 2, germa "a", si më poshtë:

Është:

- Në rastet kur Furnizuesi konstaton se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme për një periudhë më të gjatë së një muaj (matësi është i dëmtuar, matësi është jashtë kushtit teknik apo mungon aksesi në të dhënat e matjes), faturimi i energjisë elektrike do të bëhet me vlerë referuese.
- Kjo vlerë do të përllogaritet bazuar në mesataren aritmetike të faturimeve me matje përgjatë 3 viteve të mëparshme, të të njëjtit muaj me atë të faturuar. Periudha e faturimit sipas këtyre vlerave referuese nuk mund të zgjasë me shumë se tre muaj.

Propozohet - Në rastet kur operatori i rrjetit konstaton se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme për një periudhë më të gjatë se një muaj (matësi është i dëmtuar, matësi është jashtë kushtit teknik apo mungon aksesi në të dhënat e matjes), leximi i energjisë elektrike do të bëhet me vlerë referuese.

- Kjo vlerë do të përllogaritet bazuar në të njëjtin konsum të muajit respektiv të vitit të mëparshëm dhe/ose me konsumin mesatar vjetor.

- Lidhur me konstatimin e bërë nga OSSH sh.a., se: "në rast se konsumi që do të faturohet muajin aktual, duke u bazuar në 3 vitet e mëparshme, nuk do të jetë i saktë dhe përdoruesi do ta ankimojë, përsëri ky rekord do të mbetet në historikun e tij të faturimit, duke bërë që edhe në të ardhmen, nëse do të jetë subjekt i kësaj mënyre faturimi, përllogaritja do të jetë e gabuar", vlerësohet se me mesataren, vjetore apo me të njëjtin konsum mujor të vitit të mëparshëm, konsumi do të jetë real edhe nëse do të ketë muaj të keqfaturuar (gjatë vitit, përsëri do të jenë bërë sistemimet me ankesë nga përdoruesi apo pa ankesë, por si rrjedhojë e procesit të leximit të matësit).

- OSSH sh.a. citon se gjatë zbatimit të vendimeve të ERE-s nr. 58/2020 dhe 24/2021, OSSH sh.a. ka përdorur vlerën referuese zëvendësuese, siç përcaktohet nga ERE në këto vendime, në pikat respektive të tyre, të vetëm një viti më parë. Lidhur me këtë pretendim vlerësojmë se vendimi i ERE-s nr. 58/2020 është marrë në kushtet e emergjencës së pandemisë COVID-19. Në ato rrethana emergjente në tërësi, stafi i institucioneve publike dhe jopublike ishte duke punuar në kushte shtëpie *(online)*.

- OSSH sh.a. konkludon, se, duke qenë se viti 2020 u prek nga situata e krijuar, si rrjedhojë e Pandemisë COVID-19, për efekt të kufizimeve gjatë periudhës së zbatimit të aktit normativ të Këshillit të Ministrave nr. 8, datë, 24.3.2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19", të ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 243, datë 24.3.2020, "Për shpalljen e fatkeqësisë natyrore", duke çuar në rënien e konsumit për konsumatorin e kategorisë private dhe rritjen e konsumit për kategorinë familjare, pas vendosjes së karantinës në rang vendi, nuk do të ishte e udhës të merrej në konsideratë si referencë konsumi i këtij viti, ndaj propozon që aplikimi i metodologjisë së re si më sipër, të fillojë në vitin 2022, në mënyrë që t'i referohemi vitit 2021.

- Analiza e mësipërme e shoqërisë OSSH sh.a., shihet me vend, pasi viti 2020 nuk mund të konsiderohet një vit normal, për shkak të problematikës së pandemisë COVID-19 edhe të aktit normativ të nxjerrë nga qeveria shqiptare, rrjedhimisht karantinimi i popullatës ka çuar në një konsum të lartë të energjisë për kategorinë familjare dhe ndryshimin e karakteristikave të konsumit të energjisë për kategori të tjera konsumatorësh.

- Me qëllimin e një diskutimi të përbashkët dhe të një analize më të thelluar mbi kërkesën e shoqërisë OSSH sh.a. për ndryshimin e vendimit të ERE-s nr. 181, datë 23.11.2016, për disa ndryshime në vendimin nr. 104, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, "Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese, në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarritshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004 dhe nr. 146, datë 24.12.2013", në referim dhe zbatim të urdhrit nr. 51, datë 6.8.2021, ERE zhvilloi një seancë dëgjimore me përfaqësuesit e saj dhe të OSSH sh.a.

- Gjatë kësaj seance u diskutua gjerësisht në lidhje me propozimin e OSSH sh.a., si dhe u kërkua që brenda muajit gusht 2021, OSSH sh.a. të përcjellë në ERE analizën e detajuar mbi të cilën mbështet propozimin e saj për ndryshime në metodologjinë e vlerave referuese, si dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, që mbështesin këtë praktikë siç propozohet.

- Me shkresën nr. 7536/1 prot., datë 2.9.2021, protokolluar me tonën nr. 715/1, datë 7.9.2021, OSSH sh.a. ka dërguar në ERE shkresën mbi analizën teknike mbi të dhënat e shoqërisë.

- Duke marrë shkas nga eksperienca e fituar gjatë periudhës së implementimit të vendimeve të Bordit të ERE-s nr. 58/2020 dhe 24/2021, OSSH sh.a. sqaron se faturimi me të njëjtin konsum mujor të të njëjtit muaj të vitit të mëparshëm dhe faturimit me konsum mesatar vjetor, është më pranë realitetit të konsumit pas balancimit dhe zbritjes në muajin pasardhës. Pra, sikurse propozohet nga OSSH sh.a. dhe miratohet nga ERE, praktikat rregullatore të miratuara me vendimet nr. 58/2020 dhe nr. 24/2021, konsiderohen të suksesshme për shoqërinë OSSH sh.a.

- Duke aplikuar këto vlera referuese zëvendësuese dhe duke iu referuar analizës teknike të kryer nga OSSH sh.a. të përcjellë në ERE me të tyren nr. 7536/1 prot., datë 2.9.2021, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka bërë me dije, se, gjatë periudhës janar 2021–prill 2021, OSSH sh.a., në zbatim të vendimit të ERE-s nr. 24, aplikoi vlerën referuese për rreth 400,000 konsumatorë në total; janë regjistruar 488 ankesa, të përkthyera në 0.1% të totalit të konsumatorëve, ku është aplikuar vlera referuese zëvendësuese, çka vërehet se numri i ankesave është i ulët. Duke parë simulimin grafik dhe shpjegimet e OSSH sh.a., se diferenca ndërmjet konsumit fakt me lexim dhe referueses zëvendësuese të propozuar nga OSSH sh.a. për t'u aplikuar, është më e vogël se ajo që do të aplikohej sipas vendimit nr. 181/2016. Pra, vërehet se vlera referuese zëvendësuese, e cila aplikohet duke marrë në konsideratë konsumin e muajit respektiv të vitit të mëparshëm, si dhe mesataren e 12 muajve të fundit është shumë pranë realitetit.

- Në vlerësim të kërkesës së përcjellë nga OSSH sh.a., ERE konstaton, se germa "b" e kërkesës së OSSH sh.a., për një ndryshim në vendimin nr. 181/2016: "Kjo vlerë do të përllogaritet bazuar në mesataren aritmetike të faturimeve me matje përgjatë 3 viteve të mëparshme, të të njëjtit muaj me atë të faturuar. Periudha e faturimit, sipas këtyre vlerave referuese, nuk mund të zgjasë më shumë se tre muaj, për qëllim saktësimi, sikurse referohet në vendimet e Bordit të ERE-s nr. 58/2020 dhe nr. 24/202, germa "b" mund të shprehet si më poshtë:

- "Në rastet kur Furnizuesi konstaton se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme për një periudhë më të gjatë së një muaj (matësi është i dëmtuar, matësi është jashtë kushtit teknik apo mungon aksesi në të dhënat e matjes), faturimi i energjisë elektrike do të bëhet me vlerë referuese. Kjo vlerë do të përllogaritet bazuar në të njëjtin konsum të muajit respektiv të vitit të mëparshëm. Periudha e faturimit sipas këtyre vlerave referuese nuk mund të zgjasë me shumë se tre muaj.

- Për kontratat e furnizimit me energji elektrike, që nuk kanë faturime të muajit referues të vitit të mëparshëm të konsumit me matje të energjisë elektrike, faturimi me vlera referuese të bëhet bazuar në mesataren e konsumit me matje të energjisë elektrike, të regjistruar gjatë 12 muajve të fundit në sistemin e faturimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së bërë nga OSSH sh.a. për disa ndryshime të pikës 2, germa "a" dhe germa "b", të vendimit të ERE-s nr. 181, datë 23.11.2016, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 104, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, "Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese, në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarritshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004 dhe nr. 146, datë 24.12.2013".

- Pika 2, germa "a", e vendimit të ERE-s nr. 181, datë 23.11.2016, propozohet të bëhet: "Në rastet kur Furnizuesi konstaton se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme për një periudhë më të gjatë së një muaj (matësi është i dëmtuar, matësi është jashtë kushtit teknik apo mungon aksesi në të dhënat e matjes), faturimi i energjisë elektrike do të bëhet me

vlerë referuese. Kjo vlerë do të përllogaritet bazuar në të njëjtin konsum të muajit respektiv të vitit të mëparshëm. Periudha e faturimit, sipas këtyre vlerave referuese nuk mund të zgjasë me shumë se tre muaj".

- Pika 2, germa "b", e vendimit të ERE-s nr. 181, datë 23.11.2016, propozohet të bëhet: "Për kontratat e furnizimit me energji elektrike, që nuk kanë faturime të muajit referues të vitit të mëparshëm të konsumit me matje të energjisë elektrike, faturimi me vlera referuese të bëhet bazuar në mesataren e konsumit me matje të energjisë elektrike, të regjistruar gjatë 12 muajve të fundit, në sistemin e faturimit.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e përfshira, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti